

Siguria dhe shëndeti në vendin e punës janë çështje të gjithëve.  
Mirë për ju. Mirë për biznesin.

# Fushata “Vende pune të shëndetshme” 2023-2025



Punë e sigurt dhe  
e shëndetshme në  
epokën dixhitale

**#EUhealthyworkplaces**

**[www.healthy-workplaces.eu](http://www.healthy-workplaces.eu)**



Agjensia Europiane  
për Sigurinë  
dhe Shëndetin në Punë



Vende Pune të Shëndetshëm

# Hyrje

Teknologjitë dixhitale ofrojnë shërbime dhe zgjidhje thelbësore për të gjithë sektorët e ekonomisë dhe për shoqërinë. Teknologjitë dixhitale jo vetëm po ndryshojnë mënyrën tonë të të punuarit, por edhe vendin dhe kohën e punës.

Robotët dhe inteligjenca artificiale (IA) mbështet dhe zëvendëson personelin që punon në mjedise të rrezikshme. Të dhënat masive mundësojnë sisteme monitorimi më të efektshme. Puna në distancë u ofron punëmarrësve më shumë autonomi dhe elasticitet.

Pavarësisht përfitimeve, ndikimi i dixhitalizimit në sigurinë dhe shëndetin në punë (SShP) është ende në zhvillim dhe i panjohur. Është e rëndësishme të studiohen sfidat dhe rreziqet potenciale dhe në funksion të tyre të përshtaten kornizat rregullatore që promovojnë dhe mbrojnë sigurinë dhe shëndetin e punonjësve.

Nëse në projektimin, zbatimin, menaxhimin dhe përdorimin e teknologjive dixhitale përdoret qasja e përqendruar te njeriu, mund të jetë e mundur të sigurohet siguria e punëmarrësve dhe produktiviteti i biznesit.

## Rreth fushatës

Objektivat janë:

- të rriten njohuritë për përdorimin e sigurt dhe produktiv të teknologjive dixhitale në të gjithë sektorët;
- të rritet ndërgjegjësimi për sfidat e SShP-së të lidhura me transformimin dixhital në punë;
- të jepet informacion për rreziqet dhe mundësitë që po shfaqen;
- të nxitet vlerësimi i riskut dhe menaxhimi i sigurt të teknologjive dixhitale në vendin e punës;
- të inkurajohet shkëmbimi i informacionit dhe praktikave të mira ndërmjet palëve të interesuara përkatëse.



## Fushata trajton këto pesë fusha parësore:

1. punën në platformat dixhitale
2. automatizimin e detyrave
3. punën në distancë dhe atë hibride
4. menaxhimin e punëmarrësve nëpërmjet IA-së
5. sistemet dixhitale inteligjente.

# Kush mund të marrë pjesë?

Të gjithë individët ose organizatat e interesuara si në nivel evropian ashtu edhe në nivel vendesh, të çfarëdo përmase dhe nga cilido sektor, sidomos:

- punëdhënësit, menaxherët, punëmarrësit dhe përfaqësuesit e SSHP-së në sektorin publik dhe privat;
- personat e kontaktit të Agjencisë Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), partnerët socialë dhe rrjetet e tyre;
- komitetet sektoriale për dialogun social;
- politikëbërësit;
- komuniteti i SSHP-së në fushën e kërkimeve dhe komitetet teknike të SSHP-së;
- inspektoratet e punës dhe shoqatat e tyre;
- autoritetet e sigurimeve shoqërore dhe autoritetet për sigurimin e detyrueshëm kundër aksidenteve;
- grupet ndërdisiplinore të ekspertëve (për etikën, legjislacionin, TI-në);
- institucionet arsimore dhe sektori arsimor në përgjithësi;
- projektuesit, programuesit dhe furnitorët e softuerëve dhe projektuesit industrialë (IA);
- komuniteti i bizneseve “start-up”;
- media.

***Është thelbësore të ndërtohet besimi duke informuar dhe konsultuar punëmarrësit dhe duke i lejuar ata të marrin pjesë në projektimin dhe zbatimin e teknologjive dhe sistemeve digjitale.***

# Si mund të përfshiheni?

- Rritni ndërgjegjësimin duke shpërndarë materialet e fushatës.
- Organizoni takime dhe aktivitete të tilla si seminare, kurse trajnimi dhe konkurse.
- Nxitni mjetet dhe burimet për menaxhimin e rreziqeve në fushën e SShP-së që lidhen me digjitalizimin.
- Ndani praktikatat e mira me rrjetet tuaja.
- Merrni pjesë në Çmimet “Praktikat e mira për vende pune të shëndetshme”.
- Përfshihuni në Javët evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
- Angazhohuni në veprimtaritë nxitëse në mediet sociale.
- Bëhuni partner zyrtar ose partner mediatik i fushatës.

## Informacione dhe burime të tjera

Vizitoni [www.healthy-workplaces.eu](http://www.healthy-workplaces.eu) për të gjetur më shumë informacion dhe burime të ndryshme që të mund të nxisni dhe mbështesni fushatën, për shembull:

- udhëzuesin dhe mjetet e fushatës si dhe materialet të tjera promovionale;
- raportime, buletinet informative, skedat e informacionit, artikujt SShPHwiki;
- mjetet, infografikët, materialet audiovizuale dhe udhëzuesit për praktikatat e mira;
- seanca informimi në rrjet për secilën prej fushave parësore.

*Na ndiqni në mediet sociale (Facebook, Twitter dhe LinkedIn) dhe shpërndani postimet tona.*

*#EUhealthyworkplaces*



## Datat kryesore

**Çelja e fushatës:**

tetor 2023

**Javët evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë:**

tetor 2023, 2024 dhe 2025

**Aktiviteti “Shkëmbimet e praktikave të mira për vende pune të shëndetshme”:**

pranverë 2025

**Rezultatet e Çmimeve “Praktikat e mira për vende pune të shëndetshme”:**

prill 2025

**Samiti “Vende pune të shëndetshme”:**

nëntor 2025

**EU-OSHA** kontribuon për ta bërë Evropën një hapësirë pune më të sigurt, të shëndetshme dhe produktive. Bashkimi Evropian e themeloi këtë agjenci në vitin 1994, me seli në Bilbao, Spanjë. Ajo bën kërkime, zhvillon dhe shpërndan informacion të besueshëm, të baraspeshuar dhe të paanshëm për sigurinë dhe shëndetin, ndërkohë që punon së bashku me organizatat në mbarë Evropën për të përmirësuar kushtet e punës.

EU-OSHA zhvillon edhe fushatat “Vende pune të shëndetshme”, të mbështetura nga institucionet e BE-së dhe partnerët socialë evropianë. Fushatat bashkërendohen në nivel kombëtar nga rrjeti i pikave të kontaktit të agjencisë. Fushata “Vende pune të shëndetshme” 2023–2025 **“Punë e sigurt dhe e shëndetshme në epokën dixhitale”** synon të rritë ndërgjegjësimin për sfidat dhe rreziqet që shoqërojnë teknologjitë dixhitale në fushën e SShP-së dhe për nevojën për t’i menaxhuar ato në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme që të nxisë kulturën e parandalimit të riskut.

## **European Agency for Safety and Health at Work**

C/Santiago de Compostela 12  
48003 Bilbao, SPANJË

Email: [information@osha.europa.eu](mailto:information@osha.europa.eu)

[www.healthy-workplaces.eu](http://www.healthy-workplaces.eu)

© European Agency for Safety and Health at Work, 2024

Riprodhimi lejohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

Për riprodhimin ose përdorimin e fotografive ku EU-OSHA nuk ka të drejta autori, leja duhet të merret drejtpërdrejt te zotëruesi i të drejtave të autorit.

Fotografitë e përdorura në këtë botim pasqyrojnë një gamë veprimtarish pune. Jo doemos ato tregojnë praktikatat e mira ose përputhjen me kërkesat legjislative.